



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 86, datë 30.04.2024**

**PËR  
MIRATIMIN E ANËTARIT TË BORDIT TË DREJTORËVE  
TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT  
“INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, në bazë të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës, administratorit/anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e riemërimit të z. Gentian Sula, si anëtar i Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit “Intersig Vienna Insurance Group” sh.a., për një periudhë 3 vjeçare.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Mimoza KAÇI**